



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr. /22

Datë: 24/01/2022

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrtari i Inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 68, nenin 69, paragrafi 1, nenin 71, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.6 si dhe nenin 92, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. të Ligjit Nr.. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bazë të Autorizimit Nr.06/2021, pas shqyrtimit të ankesës me nr.protokoli 33, të parashtruar më datë 13.01.2022, ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shqiptohet gjobë ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, me adresë në Rr. Bill Kllinton, Prishtinë, në vlerë prej €20.000 (njëzetmijë), për përpunimin e kundërligjshëm të të dhënave personale.
2. Obligohet Administrata Tatimore të Kosovës që shumën prej €20.000 (njëzetmijë) ta paguajë, në afat prej 15 ditësh, në xhirrollogarinë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi Nr. 100040007000****/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
3. Urdhërohet Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës të bëjë largimin e listave me të dhënat personale të personave fizik, të cilat janë të publikuara në web faqen zyrtare të saj dhe të bëjë shkatërrimin e këtyre listave.
4. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, që të ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia), më datë 13.01.2022, ka pranuar një ankesë me nr.protokoli 33, nga një qytetar anonim, i cili ka shpjeguar se Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), në emër të raportimit të punëdhënësve, të cilët nuk deklarojnë punëtorët, po cenon të drejtat e privatësisë, duke i ekspozuar të dhënat personale të punëtorëve, respektivisht qytetarëve. Në aplikacionin të cilin është duke e promovuar ATK, mjafton të keni numri personal të cilitdo qytetarë

të Kosovës dhe do të qaseni në listën e të dhëna të tij, respektivisht në të dhënat e punëdhënësit. Linku i aplikacionit të ATK-së është <https://apps.atk-ks.org/regemployer>
Më tutje, ankuesi deklaron se aplikacioni nuk ka parametra të sigurisë, si fjalëkalim apo emër përdoruesi dhe se qytetarët janë të ekspozuar të jenë subjekt i keqpërdorimeve të ndryshme. Në ankesën e parashtruar në Agjenci, i njëjti ka bashkëlidhur në cilësinë e provës edhe dy linqe, në të cilat gjenden të dhënat personale të qytetarëve të cilat supozohet se kanë përfituar nga Ligji Nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike.

Provë: <https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/2.-Personat-Fizik-2000-2008-2.xlsx>;
<https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/4.-Personat-Fizik-2009-2014-3-1.xlsx>

Në mbështetje të nenit 68 të Ligjit Nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas ankesës, më datë 13.01.2022, Agjencia ka filluar procedurën e inspektimit për verifikimin e pretendimeve të ankuesit. Për shkak të ndjeshmërisë së çështjes lidhur me pretendimit se janë të publikuara listat me të dhëna personale, është filluar veprimi për të vërtetuar provën e cila është bashkëlidhur në ankesë. Në momentin e hapjes së këtyre linqeve, ka filluar shkarkimi i dokumenteve të cilat janë në formatin e microsoft excel (.xlsx) dhe përmbajnë të dhëna personale të qytetarëve. Në linkun e parë (<https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/2.-Personat-Fizik-2000-2008-2.xlsx>), gjendet lista me emërtimin “2.-Personat-Fizik-2000-2008-2.xlsx”, në të cilën shfaqet një tabelë me 4 kolona – Nr. Rendor, Emri, Mbiemri, NIP (që ka kuptimin e numrit personal). Në këtë tabelë, sipas numrit rendor gjenden të dhënat e tremijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë (**3817**) personave fizik, duke përfshirë të dhënat si **emrin, mbiemrin dhe numrin personal**. Emërtimi i faqes (sheet) është “Për Publikim”.

Në linkun e dytë (<https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/4.-Personat-Fizik-2009-2014-3-1.xlsx>), gjendet lista me emërtimin “4.- Personat-Fizik-2009-2014-3-1.xlsx”, në të cilën shfaqet një tabelë me 4 kolona – Nr. Rendor, Emri, Mbiemri, NIP (që ka kuptimin e numrit personal). Në këtë tabelë, sipas numrit rendor gjenden të dhënat e dymijë e pesëqind (**2500**) personave fizik, duke përfshirë të dhënat si **emrin, mbiemrin dhe numrin personal**. Emërtimi i faqes (sheet) është “Për Publikim”.

Për më tepër, Agjencia më datë 13.01.2022, ora 08:50, ka bërë verifikimin e faqes zyrtare të ATK-së (www.atk-ks.org) dhe në rubrikën e cila gjendet në anën e djathtë lartë të web faqes, rubrika “**Kërko**”, përmes shënimit të fjalisë “Falja e borxheve”, shfaqen dokumente të ndryshme në mesin e së cilëve gjenden edhe dy dokumente me emërtimin “Lista e personave fizik 2000-2008” dhe “Lista e personave fizik 2009-2014” (<https://www.atk-ks.org/falja-e-borxheve-tatimore/>). Nga hapja e këtyre dokumenteve është konstatuar se janë po të njëjtat lista, të cilat janë shkarkuar nga linku i bashkëlidhur si provë nga ankuesi, me të gjitha të dhënat personale të personave fizik. Data se kur janë publikuar këto dokumente me të dhëna personale në faqen zyrtare të ATK, nuk është e shënuar. Nga verifikimi i të dy dokumenteve të publikuara, rezulton se gjashtëmijë e treqind e shtatëmbëdhjetë (**6317**) personave fizik iu janë publikuar të dhënat personale.

Më pas, zyrtarët e Agjencisë, më datë 13.01.2022, në ora 13:15, kanë zhvilluar edhe një inspektim sipas ankesës në Administratën Tatimore të Kosovës (kontrollues i të dhënave), Zyra Qendrore, në

Prishtinë, ku janë takuar me Drejtorin e Departamentit të Teknologjisë Informative të ATK-së. Gjatë inspektimit është kërkuar që me shkrim, në mënyrë zyrtare të paraqesin bazën ligjore për grumbullimin dhe publikimin e këtyre të dhënave si dhe kohën kur janë publikuar këto lista. Në po të njëjtën ditë, në ora 16:20, Agjencia ka pranuar sqarimet lidhur me kërkesat e parashtruara gjatë inspektimit. Në shkresën (e-mail) të dërguar nga Drejtori i Teknologjisë Informative të ATK-së, është dhënë sqarimi se baza ligjore për mbledhjen dhe publikimin e këtyre të dhënave është Ligji Nr. 05/L-043 për faljen e borxheve, koha kur janë publikuar këto lista është përafërsisht në kohën e implementimit të ligjit për faljen e borxheve, si dhe më vonë është bërë përditësimi i tyre.

Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDHP) përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas nenit 3 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.1.) të LMDHP-së, me **të dhëna personale** nënkuptojmë çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.

Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit, publikimi i të dhënave personale nënkupton përpunim të të dhënave. Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, Ligji në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.2) përcakton se me **përpunim** nënkuptojmë “*çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi*”. Bazuar në këtë mbledhja por edhe publikimi i të dhënave personale hyn në kategorinë e përpunimit të të dhënave personale dhe si i tillë duhet të jetë i ligjshëm.

LMDHP parasheh parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale që duhet respektohet me rastin e përpunimit të të dhënave personale. Njëri ndër këta parime është parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës, në bazë të të cilit të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave.

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet së paku një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDHP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në përputhje me ligjin.

Ligji Nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike (LFBP), i cili është miratuar në vitin 2015, ka për qëllim faljen e borxheve publike ndaj Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike, si dhe përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për faljen e këtyre borxheve, që personat fizikë dhe juridikë kanë për periudhën deri më 31 dhjetor 2008. Neni 5 i LFBP-së, parasheh që të gjitha Institucionet

Shtetërore dhe Ndërmarrjet Publike janë të detyruar që brenda 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, t'i identifikoj dhe përgatis listat e të gjithë personave, të cilët duke iu nënshtuar dispozitave të nenit 4 të këtij ligji, mund të përfitojnë nga falja e borxheve publike për periudhën deri më 31 dhjetor 2008. Neni 6 (paragrafi 4) i këtij ligji në të cilin janë përcaktuar procedurat dhe afatet kohore për zbatim të ligjit, është paraparë se “subjektet që mund të përfitojnë nga falja e borxheve publike sipas nenit 4 të këtij ligji, këtë të drejtë mund ta realizojnë brenda periudhës prej një (1) viti, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji”. Ndërsa neni 7 i LFBP-së, parasheh që sipas propozimit të Ministrisë së Financave, Qeveria e Republikës së Kosovës miraton akt nënligjor për zbatimin e këtij ligji.

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e 49, me vendimin Nr.04/49 të datës 16.09.2015 ka miratuar Udhëzimin Administrativ (QRK) – Nr. 04/2015 për procedurat e faljes së borxheve publike (në tekstin e mëtejme “UA”). Neni 4 i UA rregullon çështjen e listave të **personave që mund të përfitojnë** nga falja e borxheve, konkretisht paragrafi 2 i këtij neni parasheh që lista duhet të përmbajë shumën e borxhit bazë, ndëshkimet, gjobat, interesin dhe obligimet tjera, dhe në listë duhet të renditen në mënyrë alfabetike, veçmas personat fizik dhe juridik. Kjo nënkupton se UA parasheh publikimin e të dhënave siç u cekë më lartë, por **jo edhe numrin personal** si numër unik identifikues.

Më pastaj, është miratuar edhe Ligji Nr. 05/L -119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike. Sipas nenit 3 të këtij ligji, është riformuluar neni 6, paragrafi 4, i ligjit bazik, me të cilin përcaktohet se “Subjektet që mund të përfitojnë nga falja e borxheve publike sipas nenit 4 të ligjit bazik, këtë të drejtë mund ta realizojnë, deri më 1 shtator 2017”. Pra, është shtyrë afati kohor lidhur me realizimin e kësaj të drejte.

Institucionet publike, bazuar në dispozitat e këtyre dy ligjeve për faljen e borxhit publik, Ligjit Nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike dhe Ligjit Nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike si dhe Udhëzimin Administrativ (QKR) Nr. 04/2015 për procedurën e faljes së borxheve publike, në kuptimin e nenit 5 të Ligjit Nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, kanë pasur ligjshmërinë për përpunimin e kategorive të caktuara të dhënave personale ashtu siç është paraparë me këto dy ligje dhe me UA në fjalë.

Kohëzgjatja e zbatimit të ligjit, sipas nenit 3 të Ligjit Nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike, ka qenë 1 shtatori 2017, ku edhe ka përfunduar e drejta për të përfitur nga falja e borxheve publike.

Numri personal, si e dhënë personale, është shenjë individuale me të cilën shumë lehtë mund të identifikohet subjekti i të dhënave dhe i njëjti mund të përpunohet vetëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e qartë të tij, apo është paraparë me ligj. Nëpërmjet numrit personal, në periudhën e digjitalizimit të shërbimeve, publikimi i tij (online) cenon rëndë privatësinë e subjektit të të dhënave dhe mund të ketë pasojë të rënda në jetën e tij. Për më tepër, për shkak të rëndësisë së tij, Agjencia konsideron se përpunimi i numrit personal duhet të bëhet vetëm sipas kushteve ligjore dhe kontrolluesi duhet të ketë kujdes të veçantë gjatë përpunimit.

Administratat Tatimore e Kosovës, përmes publikimit të të dhënës “*numrit personal*” të personave fizik në web faqen e saj, pa bazë të duhur ligjore shkelë dispozitat e ligjore, për arsye se ekspozon

një të dhënë unike të tij dhe këtë në rrjet (internet) ku ka qasje numër i pakufizuar i vizitorëve. Dhe për më tepër publikimi i kësaj të dhëne është në kundërshtim edhe me Ligjit Nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike, Ligjit Nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike si dhe Udhëzimin Administrativ (QKR) Nr. 04/2015 për procedurën e faljes së borxheve publike.

Administrata Tatimore e Kosovës, në cilësinë e kontrolluesit, nuk ka pasur bazë ligjore të duhur që të publikoj numrat personal të subjekteve të të dhënave në web faqen e saj dhe me këtë veprim ka përpunuar të dhënat personale në kundërshtim me nenin 4 dhe 5 të LMDHP-së dhe ka kryer kundërvajtje nga neni 92, paragrafi 1 i LMDHP-së.

Agjencia për Informim dhe Privatësi pas inspektimit të kryer dhe shqyrtimit të rastit, vërtetimit të gjendjes faktike, numrin e subjekteve të të dhënave të prekura dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 24.01.2022]

Departamenti për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh nga data në të cilën është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Administratës Tatimore të Kosovës,
- Zyrës së Komisioneres,
- Departamentit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,
- Arkivit të Agjencisë.